


Aksidentet Rrugore

Prill, 2018

Tiranë, më 21 Maj 2018: Në muajin Prill 2018 numërohen 134 aksidente rrugore, nga 150 aksidente të ndodhur në Prill 2017, duke u ulur me 10,7 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Prill 2014 – Prill 2018



Në Prill 2018, numri i të aksidentuarve është 168 persona, nga 190 që ishte një vit më parë, duke u ulur 11,6 %. Numri i të aksidentuarve në katërmujorin e parë 2018 është 651, duke u ulur me 9,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Prill 2018, numri i vdekurve nga aksidentet rrugore është 14 persona, nga 22 që ishte një vit më parë për të njëjtën periudhë, duke u ulur me 36,4 %. Në katërmujorin e parë 2018, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 61, duke u ulur me 20,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Prill 2018, aksidentet rrugore, në 85,1 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grupmosha 25 – 35 vjeç, duke zënë 30,6 % dhe ulur me 12,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në katërmujorin e parë 2018, aksidentet rrugore, në 19,8 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është rritur 19,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Prill 2017	150	2	20	47	121	
Prill 2018	134	4	10	41	113	
Ndryshimi vjetor (%)	-10,7	100,0	-50,0	-12,8	-6,6	
Janar -Prill 2017	538	13	64	204	439	
Janar -Prill 2018	504	13	48	174	416	
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-6,3	0,0	-25,0	-14,7	-5,2	

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Prill 2017	137	13	2	20
Prill 2018	114	20	4	10
Ndryshimi vjetor (%)	-16,8	53,8	100,0	-50,0
Janar -Prill 2017	454	84	13	64
Janar -Prill 2018	404	100	13	48
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-11,0	19,0	0,0	-25,0

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	Moshë						Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Prill 2017	0	34	47	26	22	18	3
Prill 2018	3	26	41	25	19	15	5
Ndryshimi vjetor (%)	-	-23,5	-12,8	-3,8	-13,6	-16,7	66,7
Janar -Prill 2017	2	119	158	85	97	40	37
Janar -Prill 2018	5	99	142	92	95	38	33
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	150,0	-16,8	-10,1	8,2	-2,1	-5,0	-10,8

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Prill 2017	Prill 2018	Prill 2017	Prill 2018	Janar - Prill 2017	Janar - Prill 2018	Janar -Prill 2017	Janar - Prill 2018
Shqipëria	150	134	22	14	538	504	77	61
Tiranë	54	60	4	3	219	230	17	14
Durrës	24	20	2	1	76	77	8	9
Shkodër	3	2	0	2	15	10	7	11
Elbasan	14	6	3	1	44	29	8	8
Fier	10	12	6	5	31	25	10	7
Vlorë	7	6	0	0	33	29	6	1
Korce	3	10	0	1	18	19	2	1
Lezhë	19	13	4	0	55	48	9	2
Berat	2	2	0	0	10	14	0	2
Kukës	8	2	1	1	16	6	2	2
Dibër	3	0	0	0	10	8	0	3
Gjirokastrë	3	1	2	0	11	9	8	1

Përkufizime

Aksidente: Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit : Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.